

URDHËR
Nr. 146, datë 19.5.2014

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS DHE AFISHIMIN E SHPALLJES SË KËRKESËS PËR NDRYSHIMIN E EMRIT/MBIEMRIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 1 dhe 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Financave

URDHËROJNË:

1. Tarifa për paraqitjen e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit të shtetasve do të jetë 200 (dyqind) lekë. Kjo tarifë parapaguhet nga kërkuesi në kohën e depozitimit të kërkesës, pranë zyrës së gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin.

2. Tarifa për afishimin e shpalljes pranë zyrës së gjendjes civile ku është depozituar kërkesa, ku kërkuesi ka vendbanimin do të jetë 400 (katërqind) lekë. Kjo tarifë parapaguhet nga kërkuesi në momentin e depozitimit të kërkesës, pranë zyrës së gjendjes civile, pasi kjo e fundit të jetë urdhëruar nga prefekti për afishimin e shpalljes së kërkesës.

3. Detyrimet financiare për afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit në dy gazeta, për një periudhë prej 15 ditësh, do të mbulohen nga kërkuesi, pasi prefekti të ketë urdhëruar afishimin e shpalljes së kërkesës. Për efekt dokumentimi, i interesuari duhet të depozitojë pranë zyrës së gjendjes civile, ku ka paraqitur kërkesën, numrat përkatës të dy gazetave ku është publikuar kërkesa për 15 ditë radhazi, dokumentacion i cili duhet t’i dërgohet prefektit brenda dy ditësh nga depozitimi i tij.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhri, nuk janë të rimbursueshme, pavarësisht vendimit përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit dhe derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDASHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani